# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-470760**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Sulm kibernetik ndaj FBI-së/ Hakerët pretendojnë se kanë vjedhur të dhënat mjekësore të mijëra agjentëve |
| ADRESA | `https://dosja.al/bota/-kibernetik-ndaj-fbi-se-hakeret-pretendojne-se-kane-vjedhur-te-dhenat-m-i516112` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 26 shtator 2026, 07:44:16 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 26 shtator 2026, 07:28:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `9db55aea67e5c1db35ee041d06ca95a730455f6df9c3ce95f8422f61d540e9dd` |
| TEKSTI | `b403e696679751df68ceb0147278937a6a311603f3b88cb361f08dc01f4d34c6` |
| PAMJA | `db906d02d021c91503327d0254e1494da27a38cf07304143a80672c8c8b788ed` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `290db7d3899f5eeb2493a212d32158667e132ea8d45df706611473e23d79d30b` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `c5ef72e280ad02d10fcefe52ca02446c3f1a387185640f8c3107dbc4e00e7b78` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/290db7d3899f5eeb2493a212d32158667e132ea8d45df706611473e23d79d30b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Bota

# Sulm kibernetik ndaj FBI-së/ Hakerët pretendojnë se kanë vjedhur të dhënat mjekësore të mijëra agjentëve

Ekspertët paralajmërojnë se rrjedhja e të dhënave, e cila po hetohet nga FBI, mund t'i ekspozojë agjentët ndaj mashtrimeve, shantazheve dhe sulmeve të synuara, si dhe tu mundësojë kriminelëve të imitojnë zyrtarë të autoriteteve ligjzbatuese.

dosja
26 Shtator 2026, 09:28
Nga E. D



foto ilustruese

**SHBA-** Hakerët që kanë sulmuar sistemet e FBI-së pretendojnë se disponojnë të dhëna jashtëzakonisht të ndjeshme mjekësore të mijëra agjentëve specialë të institucionit amerikan. BBC ka parë mostra të dokumenteve mjekësore të vjedhura, të cilat lidhen me kontrollet e aftësisë për punë dhe përmbajnë të dhëna si rezultatet e analizave të gjakut dhe urinës, si dhe shënime të mjekëve për probleme shëndetësore, përfshirë raste alergjie ndaj frutave të detit dhe bananeve.

Dokumentet përmbajnë emrat e plotë dhe adresat e agjentëve, si dhe referenca për probleme të ndryshme shëndetësore, përfshirë "gjak në urinë" dhe "kolesterol të lartë". Ekspertët paralajmërojnë se rrjedhja e të dhënave, e cila po hetohet nga FBI, mund t'i ekspozojë agjentët ndaj mashtrimeve, shantazheve dhe sulmeve të synuara, si dhe tu mundësojë kriminelëve të imitojnë zyrtarë të autoriteteve ligjzbatuese.

FBI nuk u është përgjigjur kërkesave për koment, por të mërkurën konfirmoi rrjedhjen e të dhënave dhe deklaroi se po heton intensivisht mënyrën se si ndodhi incidenti. Grupi i krimit kibernetik ShinyHunters njoftoi të hënën se kishte depërtuar në sistemet e FBI-së dhe publikoi detaje të sulmit në faqen e tij në darknet.

Grupi publikoi gjithashtu mostra të të dhënave që pretendon se janë vjedhur. Ato përmbajnë emra, adresa, numra telefoni, numra identifikimi, titujt e pozicioneve të punës, si dhe informacione lidhur me partnerët e punonjësve. Dokumentet duket se lidhen me mijëra agjentë, përfshirë edhe zëvendësdrejtorë të FBI-së.

Fillimisht u vlerësua se sulmi mund të kishte prekur rreth 38 mijë punonjës të FBI-së. Megjithatë, hakerët pretendojnë tashmë se numri mund të arrijë në 60 mijë punonjës aktualë dhe ish-punonjës të institucionit. Në mënyrë jo të zakonshme për sulme të këtij lloji, hakerët nuk po kërkojnë para.

editoriale

Eriseld Zeneli
Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Irena Beqiraj
Kostot e jetesës edhe lajmi se ekonomia po ecën mirë

Në vëmendje

BOTA 26 SHTATOR 2026, 09:28
Sulm kibernetik ndaj FBI-së/ Hakerët pretendojnë se kanë vjedhur të dhënat mjekësore të mijëra agjentëve

BOTA 26 SHTATOR 2026, 09:22
A mund të bëhet Bjellorusia furnizuese kryesore e SHBA-së me potas?

Në vend të kësaj, ata kërkojnë tërheqjen e një deklarate të publikuar nga FBI në muajin maj, e cila, sipas pretendimit të tyre, i kishte fyer. Hakerët kanë paralajmëruar se do të publikojnë të gjithë bazën e të dhënave, nëse FBI nuk plotëson kërkesat e tyre. ShinyHunters është një grup ndërkombëtar hakerësh që vepron që prej vitit 2019 dhe është lidhur me një sërë sulmesh kibernetike në shkallë të gjerë./**Dosja.al**

fbi shba


POLITIKE 25 SHTATOR 2026, 22:40

"Prania besnike e Edi Ramës dhe Erion Braçes"/ Aktivistja përplaset me deputetin: Qeverisë tuaj duhet t'i vijë turp që ka guxim të dalë përballë qytetarëve


## Sondazh

Poll


## më të klikuarat

"Të q*fsha motrën"/ Shefi i Policisë së Krujës shan qytetarin, ai zbret nga makina dhe e qëllon me shpullë (VIDEO)

VIDEO/ Pamje të rënda nga atentati në Sarandë! Artan Myrtaj vrapon për tu shpëtuar plumbave, autorët e ndjekin dhe qëllojnë në mes të rrugës

"Europa nuk ka arritur ta zbatojë"/ Rama nga SHBA: Paqja kusht politik që zhvillimi ekonomik e bën të mundur

Vodhi 700 mijë €/ Ish-drejtoresha e Postës Durrës i shpëton burgut, gjykata i zëvendëson masën në "arrest shtëpi"



Bota

26 Shtator 2026, 09:22

## A mund të bëhet Bjellorusia furnizuese kryesore e SHBA-së me potas?

foto ilustruese SHBA- Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka thënë se me Bjellorusinë po diskutohet një "marr&...

### Trump refuzon armëpushimin 7-ditor të propozuar nga Irani, pritet të rifillojë bombardimet pas zgjedhjeve të nëntorit

Bota

26 Shtator 2026, 08:46

### Partitë e ekstremit të djathtë dhe të majtë festojnë sukses pas suksesi/ Analiza e DW: Pse po i tremb kjo njerëzit

Bota

26 Shtator 2026, 08:37

### Italia ndalon burkën në shkolla/ Giorgia Meloni mbështet masën: Nuk pranohet fshehja e fytyrës

Bota

26 Shtator 2026, 08:30



## insights

Bledian Koka

I vetmi Kryeminister!

Besmir Semanaj

Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani

Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

## Moti

Powered by tomorrow.io

### I akuzuari për shpërthimin në Nord Stream, DW: A do ta ekstradojë Kroacia Vladimir Zhuravlev?

Bota

26 Shtator 2026, 08:26

Bota

26 Shtator 2026, 07:41

## Industria e veshjeve e këpucëve po kalon krizën më të thellë në historinë e tranzicionit

TIRANË- Për të katërtin vit radhazi, industria e prodhimit të këpucëve po humbet terren. Ky segment, ku veprojnë disa ...

### Shpërthejnë protestat në Gjermani/ Të rinjtë kundërshtojnë rikthimin e shërbimit ushtarak të detyrueshëm

Bota

25 Shtator 2026, 22:50

### SHBA-ja synon ta kthejë marrëveshjen e transitit Armeni-Azerbajxhan në mundësi investimi

Bota

25 Shtator 2026, 20:50

### VIDEO/ Rritja e çmimit të karburantit ndez protestat në Portugali, 500 kamionë dalin në rrugë

Bota

25 Shtator 2026, 17:45

### Kushtetuesja në Bosnje ndalon financimin për lobim lidhur me shkëputjen e Republikës Sërpska

Bota

25 Shtator 2026, 17:25

## MË SHUMË





Aktivistja përplaset me deputetin: Qeverisë tuaj duhet t'i vijë turp që ka guxim të dalë përballë...


“Nesër më shumë”/ Mbyllet protesta e 118-të: Arrestoni Ramën


Mbyllen fjalimet te Kryeministria, nis marshimi në rrugët e Tiranës


Rama mbajti fjalimin në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së, por salla ishte pothuajse bosh

## Aktivistja përplaset me deputetin: Qeverisë tuaj duhet t'i vijë turp që ka guxim të dalë përballë...

Shiko video te tjera



Dosja.al është një iniciativë gazetarësh të rinj dhe njerëzish të lirë, që nuk ndikohet nga interesa politike apo biznesi. Informimi i paanshëm, qëndrimi i pavarur dhe etika profesionale janë parimet tona. Ka media të majta, të djathta, ka media në shërbim të partive apo biznesit, por ka edhe të pavarura, që kanë zgjedhur rrugën më të vështirë, por më të ndershme dhe më të sigurtë për të qenë të besueshëm. Dosja.al do të jetë gjithmonë e pavarur, e vërtetë, në krah të interesit publik.

Telefon/Whatsapp: +355 68 2676 444
Email: [email protected]



MUNDESUAR NGA Mediadesk

**Drejtor: Enton Abilekaj**

**Kryeredaktor: Izmir Akulli**

**Gazetarë:**
Esmeralda Doçi
Emanuela Dida
Elisa Karaj
Dorotea Simoni

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.